



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/05-103059/26, më 10 JUL 2026

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale, nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet caktimi i personit përgjegjës për implementimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit për funksionalizimin e Orkestrës së Kryeqytetit të lidhur ndërmjet Kryeqytetit dhe Organizatës për bashkëpunime artistike Eho me nr. 14-024/01-91266/25 e dt. 24.06.2025.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, person përgjegjës caktohet z. Ilir Loshi nga Drejtoria e Kulturës.
3. Detyrë dhe punë e personit përgjegjës është: Mbikëqyrja dhe implementimi i marrëveshjes, konstatimi i punëve të kryera nga organizata dhe ndërmarrja e veprimeve sipas obligimeve të përcaktuara në Marrëveshje sipas Thirrjes Publike të datës 21 Janar 2025.
4. Për kryerjen e punëve si në pikën 3 të këtij Vendimi, personi përgjegjës do t'i raportoj Kryetarit të Kryeqytetit.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e marrjes së tij.

I DORËZOHET:

- Z. Ilir Loshi;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

